



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Këshillit Prokurorial të Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të KPK kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori i Sekretariatit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Sekretariatit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Këshillit Prokurorial të Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Këshillit Prokurorial të Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Këshillit Prokurorial të Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e pasurisë dhe komitetin e auditimit të brendshëm.

Ky raport ka rezultuar me tri rekomandime dhe të gjitha janë rekomandime të reja.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike: mallrat dhe shërbimet dhe investimet kapitale.

Çështja A1 - Mungesa e raportit për monitorimin dhe vlerësimin e përfomances së kontratave/kontraktuesve

Gjetja

Rregullorja 01/2022 për Prokurimin Publik, neni 70.2 parasheh se vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet në sistem të prokurimit elektronik nga menaxherët e kontratës nëpërmjet të modullit për vlerësim të performancës së kontraktuesve, gjatë dhe me përfundim të implementimit të kontratave publike dhe kontratave kornizë. Si dhe neni 73.1 Autoritetet kontraktuese nëpërmjet menaxhereve të kontratës dhe sistemit të prokurimit elektronik do të mirëmbajnë një përmbledhje të shënimeve të menaxhimit të kontratës lidhur me çdo procedurë prokurimi.

Në dhjetë raste nga njëmbëdhjetë të audituara, menaxherët e kontratave nuk kanë përgatitur raportin për monitorim të kontratave. Raportet e gjeneruara nga sistemi e-prokurimi nuk kane evidenca mbi dorëzimet, pagesat (faturat) apo çfarëdo arsye që lidhet me menaxhimin e kontratave. Po ashtu KPK nuk ka bërë vlerësim të performancës së kontraktuesve (OE) gjatë dhe me përfundim të implementimit të kontratave ekzistuese.

Kjo për shkak të veprimeve të pa mjaftueshme të menaxhmentit për të vënë në funksion menaxhimin e kontratave përmes e-prokurimit dhe nga mungesa e trajnimeve të menaxherëve për përdorimin dhe përgatitjen e këtyre raporteve.

Ndikimi

Mungesa e raporteve për monitorimin e kontratave dhe vlerësimi e performancës së kontraktorëve, ndikojë në menaxhimin jo efektiv dhe transparent të kontratave duke mos ofruar të dhëna mbi obligimet kontraktuese apo ngecjet në realizimin e kontratave. Po ashtu mungesa e këtyre raporteve ndikon që vendimmarrësit dhe përdoruesit tjerë të mos kenë informata lidhur me menaxhimin e kontratave dhe përfomimin e operatorëve ekonomik.

Rekomandimi A1

Kryesuesi i KPK-së duhet të sigurojë se menaxheret e kontratave përgatitin raportin për monitorim të kontratave përmes sistemit e-prokurimi, duke evidentuar informatat relevante mbi progresin kohor, dinamikën e pranimeve dhe pagesave. Po ashtu të sigurojë vlerësimin e performancës së kontraktuesve/OE gjatë dhe me përfundim të implementimit të kontratave publike dhe kontratave kornizë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Pasuria kapitale neto e prezantuar në pasqyrat financiare është 6,081,308€, ajo jo kapitale 309,339€ dhe stoqet në vlerë 17,922€. Regjistrimi i pasurisë jo kapitale, dhe evidentimi i drejtë i saj mbetet sfidë për KPK-në, si rrjedhojë janë identifikuar mangësitë e mëposhtme.

Çështja A2 - Regjistra jo të saktë të pasurisë

Gjetja Sipas rregullores MF 02/2013, neni 6, përcakton së pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”, sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël.

Gjatë ekzaminimit të mostrave kemi vërejtur mangësi në regjistrin e pasurisë kapitale dhe jo kapitale:

- Projekti "Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për përkthim" në vlerë prej 69,320€, nuk është regjistruar plotësisht në regjistrin e pasurisë kapitale. Prej tyre, vetëm 44,535€ janë evidentuar në regjistrin e pasurisë kapitale, ndërsa 23,985€ janë evidentuar gabimisht në regjistrin nën 1,000€, përderisa vlera prej 800€ nuk është evidentuar në asnjë regjistër duke u konsideruar si shërbim. Megjithatë në fillim të vitit 2025, KPK ka filluar të ndërmarr masa për regjistrimin e duhur të tyre.
- Pagesa në vlerë 75,094 për projektin "Renovimin dhe Prokurorisë Themelore Prishtinë" është regjistruar në tërësi në regjistrin e pasurisë kapitale si ndërtesë administrative, me afat të paraparë të zhvlerësimit prej 40 vite. Nga ky regjistrim vlera prej 7,100€, janë shpenzime për mobileje mbi 1,000€ që sipas planit kontabël zhvlerësohen për 5 vite, ndërsa vlera prej 7,635€ janë shpenzime për mobileje nën 1,000€, që për nga natyra i takojnë mallrave dhe shërbime dhe duhet të regjistrohen në e-pasuria.
- Në furnizimet me inventar/karrika në vlerë totale 2,730€, nuk janë regjistruar në regjistrat e pasurisë nën 1,000€.

Kjo ka ndodhur për shkak të pakujdesisë së zyrtarëve përgjegjës për regjistrimin e pasurisë dhe mungesës së kontrolleve të brendshme në nivel të organizatës.

Ndikimi Mangësitë në evidentimin dhe regjistrimin jo të duhur të pasurive kanë shkaktuar regjistra të pa saktë të pasurive si dhe prezantim jo të drejtë dhe të vërtetë të informatave në PFV.

Rekomandimi A2 Kryesuesi i KPK-së duhet të forcoj kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive dhe të siguroj që pasuritë evidentohen në regjistra përkatës sipas legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të mundësohet regjistër i plotë i pasurisë dhe raportim i drejtë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

KPK ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm, që funksionon me një auditorë, i cili është edhe udhëheqës i njësisë, po ashtu ka themeluar Komitetin e Auditimit, mirëpo gjatë vitit 2024 kemi identifikuar këtë mangësi.

Çështja A3 - Përbërja jo e plotë e Komitetit të Auditimi

Gjetja Udhëzim administrativ 01/2019 Për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, neni 6 përcakton se Komiteti i Auditimit emërohet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe përbëhet nga tre (3) ose pesë (5) anëtarë dhe Neni 8 Takimet e Komitetit të Auditimit 1. Takimet e Komitetit të Auditimit mbahen së paku katër (4) herë në vit dhe ftohen nga kryesuesi i Komitetit të Auditimit. Takimi mbahet nëse shumica e anëtarëve të Komisionit të Auditimit marrin pjesë në takim.

Nga prilli 2024, Komiteti i Auditimit, ka funksionuar pa kryetar të komitetit, i cili ka përgjegjësi për përmbushjen e obligimeve ligjore, si ftesën për takime, miratimin dhe nënshkrimin e planit vjetor të punës për vitin vijues, statutet të KA dhe të NJAB, planin strategjik etj. Gjatë vitit 2024 janë mbajtur 4 takime ku vetëm në takimin e parë ka marr pjesë kryesuesi dhe procesverbali është nënshkruar edhe nga ai, ndërsa procesverbalet e tri takimeve tjera të mbajtur gjatë vitit 2024 (i katërti është mbajtur me 14.01.25) dhe raporti final janë nënshkruar vetëm nga dy anëtarët e KA.

Edhe përkundër përpjekjeve për emërimin e kryesuesit, KPK nuk ka arritur që gjatë vitit 2024 ta përmbush këtë kërkesë ligjore. Megjithatë, KPK ka themeluar komitetin e ri prej tre anëtarëve në mars 2025.

Ndikimi Mungesa e kryesuesit paraqet vakum ligjor në përbërjen e plot të komitetit të auditimit duke mos i realizuar të gjitha kërkesat ligjore.

Rekomandimi A3 Kryesuesi i KPK duhet të sigurojë se KA të jetë në përbërje të plotë dhe të kryej rolin dhe marr përgjegjësit sipas kërkesave ligjore në të kundërtën mos përmbushja e këtij obligime paraqet parregullsi në funksionimin e KA.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	17,265,867	15,733,099	15,130,313	14,143,932	13,419,514
Grante Qeveritare - Buxheti	17,265,867	15,733,092	15,130,313	14,143,932	13,419,514
Donacionet e jashtme	0	7	0	0	0

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 1,532,767€. Ky ndryshim ishte rezultat i zvogëlimit të buxhetit për investime kapitale për 1,606,318€, pastaj rritjes së buxhetit për paga dhe mëditje për 73,544€ dhe rritjes me donacione për 7€.

Në vitit 2024, KPK ka shpenzuar 96% të buxhetit përfundimtar ose 15,130,313€, që është i ngjashëm me vitin 2023.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	17,265,867	15,733,099	15,130,313	14,143,932	13,419,514
Pagat dhe mëditjet	11,368,845	11,442,388	11,442,388	10,892,600	10,627,301
Mallrat dhe shërbimet	3,292,892	3,292,899	2,930,837	2,892,947	2,308,176
Komunalitë	199,630	199,630	173,725	132,589	117,342
Investimet Kapitale	2,404,500	798,182	583,363	225,795	366,695

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


- Tek pagat dhe mëditjet, buxheti përfundimtar është rritur për 73,544€. Kjo rritje është rezultat i vendimit të qeverisë nr.03/239 të datës 24.12.2024 për mbulimin e pagave të rregullta dhe kujdestarisë. Realizimi në këtë kategori është 11,442,388€ apo 100%.

- Tek mallrat dhe shërbimet, buxheti përfundimtar në raport me buxhetin fillestar është rritur për 7€, që janë donacione të bartura nga vitet e kaluara. Realizimi është 2,930,837€ apo 89%.

- Tek komunalit, buxheti fillestar dhe ai final është i njëjti, ndërsa realizimi është 173,725€ apo 87%.

- Tek investimet kapitale buxheti përfundimtar është zvogëluara për 1,606,318€, sipas vendim të qeverisë nr.03/239 të datës 24.12.2024, për kursime buxhetore. Zvogëlimi i buxhetit është rezultat i mos realizimit të dy projekteve kapitale të planifikuara. Projekti “Blerja e tokës për Prokurorinë Themelore në Mitrovicë” dhe “Ndërtimi i objektit të Prokurorinë Themelore në Mitrovicë”, nuk kanë arritur të realizohen pasi që ende nuk është përcaktuar toka/parcelsa se ku do të blihet dhe pastaj të bëhet ndërtimi si dhe nivelit i ulët i realizimit të projektit “Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike të KPK-së”, në të cilin janë të përfshirë të gjitha objektet e KPK-së. Realizimi në këtë kategori është 583,363€ apo 73% në raport me buxhet final.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



KPK në vitin 2024 ka pranuar të hyrat në vlerë 115,373€. Këto kanë të bëjnë me të hyrat që pranohen sipas Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, përkatësisht neni 227 Pezullimi i përkohshëm i procedurës, pika 1.2, duke i destinuar në Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	29,461	29,461	115,373	47,760	11,330
Të hyrat jo tatimore	29,461	29,461	115,373	47,760	11,330

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2023 të Këshillit Prokurorial të Kosovës ka rezultuar me një rekomandim. KPK kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohet rekomandimi dhe dhënë.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, rekomandimi është zbatuar, dhe përshkrim më i plotë i rekomandimit dhe mënyrën se si është trajtuar, shihni në Tabelën 4.


Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasuritë	Kryesuesi i KPK-së duhet të sigurojë se pasuritë të cilat janë pranuar teknikisht dhe janë në përdorim, të evidentohen në regjistrin e pasurisë si pasuri në përdorim, duke aplikuar edhe shpenzimet e zhvlerësimit, me qëllim të paraqitjes së drejtë të vlerës së tyre në PVF. Po ashtu, Kryesuesi i KPK-së duhet të sigurohet se pozita e zyrtarit të pasurisë mbulohet me staf të rregullt.	Sipas plani për implementimin e rekomandimeve, pasuria nga investimi në vijim do të kthehet në përdorim, nga momenti i pranimit teknik.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Qëndresa Isufi, Udhëheqëse e ekipit



Luljeta Morina, Anëtare e ekipit



Albesa Tolaj, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilaški Savet Kosova/ Kosovo Prosecutorial Council

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), për vitin 2024 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Samir Istrefi



Drejtor i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës,

Data: 19.06.2025, Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.